



Për/To :	z. Bashkim Ramosaj , Kryetar i Komunës Deçan
Nga/From :	z. Sami Gjirkokaj , Drejtor i Njesisë se Auditimit i Brendshëm
Tema/Subject:	Raporti vjetor i punës për vitin 2025

Raporti **Vjetor 2025** lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm është pjesë e administratës së Komunës në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës ,pra NJAB i ushtron kompetencat e veta në përputhje me Ligjin nr.06/L-121 për kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në përmbushjen e detyrave të tij/saj do të jetë llogaridhënëse ndaj Kryetarit të Komunës , Komitetit të Auditimit dhe Njesisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQAHB) në Ministrinë e Financave dhe Transfereve.

Qëllimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është të ofroj shërbime të pavarura , objektive , sigurorese dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtojnë vlerën dhe të përmirësojnë operacionet e organizatës .Ai i ndihmon organizatës që të arrijë objektivat e saja duke sjelle një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut , kontrollit dhe qeverisjes.

Drejtori i NJAB-se dhe Auditorët e Brendshëm kanë përgjegjësi që të :

- Dorëzoj planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm tek NJQHAB jo më vonë se 31 Dhjetor të secilit vite kalendarik pas miratimit nga Kryetarit dhe Komiteti i Auditimit .

Duke u bazuar në planin vjetor të NJAB-se për vitin 2025 kanë qene të planifikuara 6 auditime të rregullta dhe janë kryer të gjitha. Gjithashtu është përpiluar raporti gjashtëmuajor I dhe gjashtëmuajor II dhe Raporti Vjetor 2025 të cilët i kemi dorëzuar tek Kryetari i Komunës dhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese –Ministria e Financave dhe Transfereve . Sa i përket Komitetit të Auditimit kanë mbajtur pesë takime të rregullta ku kanë dalur me rekomandime për menaxhmentin e Komunës.

Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm

Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij (për të cilat janë përpiluar raportet finale)

Periudha raportuese	Numri i auditimeve të planifikuara	Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të kryera	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim
Gjashtëmuajori I	3	60	2	3	66	2
Gjashtëmuajori II	3	85	2	3	119	2
Vjetore	6	165	2	6	185	2

Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:

Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:	48
Numri i rekomandimeve të zbatuara:	23
Numri i rekomandimeve në proces:	12
Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	13
Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara thekso arsyet e moszbatimit: Mos zbatimi i rekomandimeve të lartcekura është për arsye se disa nga rekomandimet kërkojnë kohe për implementim dhe gjithashtu është problem përcjellja e implementimit për arsye se asnjë nga njësitet e audituara nuk ka përpiluar planin e implementimit të rekomandimeve.	
Të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese janë :	
1 . Shërbimet Publike-Menaxhimi i kontratave	
2 . Zyra e Kryetarit– Shpenzimet nga kategoria e subvencioneve	
3. Zyra e Personelit – Menaxhimi i personelit	
4. Buxhet dhe Financa – Te hyrat dhe Shpenzimet nga të gjitha kategorit ekonomike	
5. Higjiena – Auditim i përgjithshëm	
6. Prokurimi – Procedurat e prokurimit	

(Nënshkrimi i Drejtorit të NjAB)